

(Emërtimi i programit të studimit) **BACHELOR NË GJUHË ANGLEZE**

Emertimi akademik i studimit	Diplomë Bachelor në Gjuhë Angleze
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me Vendim nr.03 , datë 10.01.2025
Cikli i studimit	
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqerore, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Anglisht dhe Shqip (dhe në ato raste kur kemi dy gjuhë shënohen të dyja gjuhët)
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	a.Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. b. Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njëhësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. c.Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania). <i>Përlllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).</i>

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit Bachelor në Gjuhë Angleze është të aftësojë studentët në përdorimin e gjuhës angleze në një nivel akademik. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit :

1. Të kenë njohuritë e nevojshme për formimin e tyre kryesisht në gjuhën angleze.
2. Të kenë njohuri të kënaqshme mbi strukturën gjuhësore, letërsinë dhe civilizimin anglo-amerikan.
3. Të njohë gjuhën angleze dhe përdorimet në fusha të ndryshme të saj.
4. Të njohë në nivelin B2 edhe gjuhën frënge si gjuhë e dytë e huaj.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e specialistit në gjuhën angleze.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi gjuhësore, historike dhe kulturore që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin/ mjediset e punës në të cilin studenti do të operojë në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të gjuhësisë, letërsisë dhe civilizimit anglo-amerikan etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. Lëndë të formimit të përgjithshëm (Bazat e gjuhësisë, Gjuhe shqipe, Njohuri mbi letërsinë, Gjuhesi e thelluar) Kredite 32 ECTS
2. Lëndë të formimit karakterizues (Gramatikë angleze I Analize teksti I, Anglishtja përmes prozës /poezisë/ drames, Gramatikë angleze II, Histori Anglo-Amerikane, Analize teksti II, Letërsi Anglo-Amerikane, Leksikologji, Teori & praktike perkthimi, Analize teksti III, Shprehje komunikimi) Kredite 96 ECTS
3. Lëndë integruese (Histori e gjuhës Angleze, Letërsi shqipe) Kredite 10 ECTS

Lëndë me zgjedhje (Lende me zgjedhje a.Anglisht e folur
b.Studim veprave letrare, c.Anglishtë Biznesi, Lende me zgjedhje : a.Shkrim Akademik, b.Studime Britanike , c.Shkrim dhe menaxhim projektesh, d.Edukimi për median dhe informacionin për mësuesit e ardhshëm, Lende me zgjedhje: Letërsi e krahasuar, Studime Amerikane Sociolinguistike) Kredite 12 ECTS (në total nr i krediteve për këtë kategori)
3. Lëndë të formimit plotësues (Gjuhe e huaj II frëngjisht, Aftësim kompjuterik, Gjuhë e huaj II frëngjisht, Gjuhë e huaj II frëngjisht) Kredite 22 ECTS
4. Përgatitje punim diplome/ Provim i përgjithshëm formimi Kredite 8 ECTS

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	0 në 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të parë “Bachelor” në *Gjuhë angleze* është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë nw punwsimin e ardhshwm.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit *Bachelor* në Gjuhë Angleze mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë Master në Mësuesi, Përkthim, Gjuhësi, Letërsi Anglo-Amerikane ose Histori Anglo-Amerikane, apo në një fushë të ngjajshme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë , në programet :

1. Master i Shkencave në Mësuesi në Gjuhë Angleze (pranë UGJ ose në programet e sipërcituara të ciklit të dytë Master)

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon operatorë turistik, specialistë zyrash të marrëdhënieve me jashtë ose publikun, mësues të gjuhëve të huaja, përkthyes ligjor të kualifikuar në fushën / fushat e gjuhësisë, letërsisë dhe përkthimit, të kualifikuar me njohuri të tilla. Për këtë arsye synimi i programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Sektorin publik (specialistë të zyrave përkatëse të marrëdhënieve me jashtë dhe publikun)
2. Sektorin privat (operatorë turistikë)
3. Hoteleri
4. Përkthyes

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit “Bachelor” në Gjuhë Angleze fitojnë njohuri në përdorimin e gjuhës angleze në një nivel akademik duke u konsideruar si kandidatë potencial për t’u punësuar në sa më sipër.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Bazat e gjuhesise	8	200	I
2.	Gjuhe shqipe	10	250	I+II
3.	Gramatikë angleze I	8	200	I
4.	Analize teksti I	10	250	I+II
5.	Anglishtja permes prozes /poez/ drames	10	250	I+II
6.	Gjuhe e huaj II frëngjisht	6	150	II
7.	Aftesim kompjuterik	4	100	II
Lëndë me zgjedhje				
8.	Lende me zgjedhje a.Anglisht e folur b.Studim veprë letrare c.Anglishte Biznesi	4	100	II
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	1500	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Njohuri mbi letersine	8	200	I
2.	Gramatikë angleze II	8	200	II
3.	Histori Anglo-Amerikane	8	200	I
4.	Analize teksti II	10	250	I+II
5.	Letersi Anglo-Amerikane	8	200	II
6.	Leksikologji	8	200	I
7.	Gjuhë e huaj II frengjisht	6	150	II
Lëndë me zgjedhje				
8.	Lende me zgjedhje a.Shkrim Akademik b.Studime Britanike c.Shkrim dhe menaxhim projektesh d.Edukimi për median dhe informacionin për mësuesit e ardhshëm	4	100	II
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	1500	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i tretë				
1.	Gjuhesi e thelhuar	6	150	II
2.	Teori & praktike perkthimi	12	300	I+II
3.	Analize teksti III	10	250	I+II
4.	Shprehi komunikimi	4	100	I
5.	Histori e gjuhes Angleze	6	150	I
6.	Letersi shqipe	4	100	II
7.	Gjuhë e huaj II frengjisht	6	150	I
Lëndë me zgjedhje				
8.	Lende me zgjedhje a.Letersi e krahasuar b.StudimeAmerikane c.Sociolinguistike	4	100	II
9.	Provim formimi / Punim diplome	8	200	II
Gjithësej viti i tretë		60 ECTS	1500	
Total : viti I + viti II + viti III		180 ECTS	4500	